



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



FTESË PËR OFERTË

Përmet, 09.09.2019

Objekti: Ekspert mjedisor

Autoriteti kontraktues: Organizata "Mjedis, Ujëra, Pyje"

Adresa: Blloku "Stavri Vinjau", 6401, Përmet

E-mail: mjedisujerapyje@gmail.com

Informacion i përgjithshëm

Organizata "Mjedis, Ujëra, Pyje" po implemeton projektin "Të rinj aktivë në mbrojtjen e mjedisit" në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD, projekt i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga UNDP. Fokusi i këtij projekti është ndërgjegjësimi i të rinjve për të qënë më aktivë në mbrojtjen e mjedisit që i rrethon, duke kontribuar në mbrojtjen dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore në rrethin e Përmetit. Ky projekt do të zbatohet në Përmet dhe target grupi janë të rinjtë e qytetit të Përmetit.

Detyrat e ekspertit

Eksperti duhet të asistojë Këshillin Mjedisor të të Rinjve, i cili përbëhet nga 15 nxënës, 5 nga çdo shkollë e qytetit. Këshilli do të monitorojë procesin e mbledhjes të diferencuar të mbetjeve në shkolla dhe do zhvillojë një takim çdo muaj (Tetor 2019-Janar 2020), për të diskutuar problematikat dhe zgjidhjet e mundshme. Eksperti duhet të marrë pjesë në tre takimet e para, për të moderuar takimin dhe një ditë duhet të shkojë të bëjë monitorimin në secilën shkollë. Pra eksperti për këtë detyrë do të angazhohet 6 ditë pune në total.

Detyra tjetër e ekspertit mjedisor është të asistojë të treja shkollat, për të krijuar produkte me materiale të ricikluara, kryesisht plastikën. Produktet do të prezantohen në formën e një ekspozite në muajin Dhjetor. Edhe për këtë detyrë eksperti do të angazhohet 6 ditë pune në total.



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



Kualifikimet e kërkuara

1. Të ketë mbaruar studimet universitare në Fakultetin e Shkencave Natyrore, Ekonomik ose Shkenca Sociale.
2. Eksperiencë pune të ngjashme me nxënësit e shkollave.
3. Preferohet të jetë përfshirë në projekte me fokus mjedisin.
4. Preferohet të jetë nga Përmeti.

Dokumentacioni i detyrueshëm

- ✓ CV e detajuar, ku të ketë edhe kontaktet për referenca pune të ngjashme.
- ✓ Kopje e diplomës
- ✓ Letër motivimi

Subjektet e interesuar duhet të dërgojnë dokumentacionin në adresën **mjedisujerapyje@gmail.com**, ose në zarf të mbyllur me postë, **deri në datën 19.09.2019**, në adresën: Blloku “Stavri Vinjau”, 6401, Përmet.

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i kandidaturave do të mbështetet duke pasur si referencë kualifikimet e kërkuara më sipër.

Mënyra e pagesës

Pagesat do të kryhen me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit.



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).